



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/12
Datë: 17.03.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 41 të Ligjit Nr. 02/L-109 për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse, të nenit 2 të Ligjit nr. 04/L-072 për kontrollin e kufirit shtetëror, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, në pajtim me nenin 17 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës në mbledhjen e mbajtur më 17 mars 2020 nxjerr këtë:

V E N D I M

Për plotësimin dhe ndryshimin e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/09, të datës 13 mars 2020

1. Ndryshohet dhe plotësohet pika 5. e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/09, të datës 13 mars 2020, ashtu që pas fjalëve "Përrjashtim bëjnë linjat e udhëtimit në ardhje me ekuipazh por pa udhëtarë, që shërbejnë vetëm për largim të udhëtarëve nga Kosova", shtohen fjalët si në vijim: "Gjithashtu, përjashtim bëjnë linjat e udhëtimit në ardhje me udhëtarë, të cilët janë shtetas të Republikës së Kosovës të cilëve ju pamundësua kthimi për shkak të Vendimit të lartpërmendur të Qeverisë Nr. 01/09, apo staf diplomatik të akredituar në Republikën e Kosovës, të cilave linja mund t'ju lejohet ardhje me leje të veçantë të Ministrit të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Ambientit, pas konsultimit me Ministrin e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrin e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës."
2. Obligohet Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës dhe institucionet tjera relevante të kryejnë të gjitha procedurat për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi menjëherë.

Albin KURTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë